



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Dr.Sc. Mazllom Kumnova

Nr.prot.: 05/1923
Datë: 16/12/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 17, paragrafi 3, të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi për stimulimin e punëtorit të vitit nga personeli administrativ i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani.
- II. Udhëzohet Sekretarja e përgjithshme e Universitetit të Gjakovës që në bazë të punës dhe performancës të bëjë zgjedhjen për punëtorin e vitit.
- III. Stimulimi do të bëhet në vlerën prej 200 (dyqind) euro.
- IV. Kompenzimi bëhet nga mjetet e buxhetit të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", nga kategoria për subvencione dhe transfere.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

A r s y e t i m

Në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2020, Këshilli Drejtues me qëllim që të përkrah punën dhe performancën e stafit administrativ të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", pas shqyrtimit të propozimit të menaxhmentit të Universitetit dhe bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dorëzohet:

- 1.Menaxhmentit të UGJFA-së;
- 3.Sekretarit të Përgjithshëm;
- 4.Njësive Akademike;
- 5.Arkivit të UGJFA-së.



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Dr.Sc. Mazllom Kumnova